



AVOKATI I POPULLIT



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Veçantë

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 201802020/6

Tiranë ___/___/2019

Lënda: *Rekomandohet vendosja e të paktën një kamere tjetër të sigurisë në seksionin e veçimit në IEVP Korçë për të monitoruar në përputhje me standartet veprimtarinë në koridorin e këtij seksioni, përmirësimi i regjistrimit të pamjeve në mënyrë që të mos ketë ndërprerje të tyre dhe sigurimi i shërbimit shëndetësor të të burgosurve pa ndërprerje nën kujdesin dhe kontrollin e personelit mjekësor dhe shëndetësor*

DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË BURGJEVE

Drejtorit të Përgjithshëm

Z. Agim Ismaili

Tiranë

IEVP KORÇË

Drejtorit

Z. Genci Fejzollari

Të nderuar zotërinj,

Në Institucionin e Avokatit të Popullit është regjistruar ankesa e të dënuarit M. Th., i cili pretendon se është goditur me shkop gome nëpërmjet dritares së dhomës nga një punonjës i grupit të sigurisë. Kjo ngjarje ka ndodhur në datën 11.10.2018, kur i dënuari ndodhej në dhomën nr. 6 në seksionin e veçimit të IEVP Korçë.

Për verifikimin e kësaj ankese janë kryer një sërë veprime hetimore si: marrja e deklarimeve me shkrim nga i dënuari M. Th., këqyrja e tij fizike, administrimi i disa dokumentave, këqyrja e regjistrave të seksionit të veçimit, këqyrja e kamerave të sigurisë së IEVP Korçë.

Në përfundim të hetimit, pasi analizuam në tërësi materialin e mbledhur, arritëm në përfundimin se pretendimi i të dënuarit M. Tha. nuk mund të provohet, por në çdo rast u vunë re disa probleme në lidhje me garantimin e të drejtave të të burgosurve, për të parandaluar ngjarje të tilla.

Nga këqyrja fizike që ndihmëskomisioneri i Institucionit të Avokatit të Popullit i bëri të dënuarit M. Th. në dt. 16.10.2018 konstatoi se, ai kishte një mavijosje në syrin e djathtë dhe dy gërvishtje në parakrahun e djathtë. Por, dinamika e ngjarjes krijon besim në variantin e dhënë nga IEVP-ja dhe jo nga i dënuari. Gjithashtu, profili psiko-social i të dënuarit dhe sjellja e tij në institucion përforcon variantin e IEVP që është si vijon: M. Th. është i burgosur me probleme të shëndetit mendor, që refuzon terapinë e përcaktuar nga

mjeku psikiatër. Ai ishte vendosur në seksionin e veçimit, sepse nuk përshtatej me bashkëvuajtësit e tjerë. Ndaj M. janë regjistruar disa raport shërbime për konflikte që ka patur me të dënuarit dhe me personelin e I EVP. Dëmtimin në sy M. e ka marrë nga shkopi i fshesës që mbante në dorë, në përpjekje për të goditur punonjësit e policisë, të cilët ishin afruar te sporteli i derës pasi kanë dëgjuar sharjet e tij.

Ky episod, por edhe episode të tjera të përsëritura janë pasqyruar në informacionin e përpiluar nga shefi i policisë dhe specialisti i regjimit. Incidenti i dt.11.10.2018, që kemi hetuar, ka pasuar edhe nga incidente të tjera, pasi i dënuari ka vazhduar qëndrimin e tij agresiv dhe refuzues edhe në ditët në vijim. Në raport-shërbimin e dt. 14.10.2018 shkruhet se, i dënuari M. Th. ka refuzuar të vizitohet nga mjekja dhe pasi ka kërkuar të bëjë një telefonatë ka tentuar të godasë një punonjës policie. Po në dt.14.10.2018, mjekia psikiatre N. B. ka arritur të konstatojë shenjat e pretenduara për dhunë dhe i ka shënuar në epikrizën mjekësore. Stafi mjekësor, edukativ dhe policor është shprehur se, shpesh nuk ishte e mundur të merrej kontakt me këtë të dënuar për shkak të veprimeve të dhunshme dhe se disa incidente M. Th. i kryente me qëllimin për tu viktimizuar dhe për të kërkuar transferimin e tij në një I EVP tjetër.

Referuar dokumentacionit të administruar dhe përgjigjes që kemi marrë së fundi nga I EVP Korçë me shkresën Nr. 1753/1 Prot., dt. 18.10.2019 rezulton se, i dënuari M. Th. është vizituar nga mjeku vetëm tre ditë pasi ka ndodhur ngjarja (ngjarja ka ndodhur në datën 11.10.2018 dhe vizita është kryer në datën 14.10.2018). Në nenin 102 të Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve parashikohet se: *“I EVP-të sigurojnë shërbim shëndetësor pa ndërprerje, nën kujdesin dhe kontrollin e personelit mjekësor dhe shëndetësor.”* dhe se *“...Çdo kontroll duhet të dokumentohet në kartelën shëndetësore të të paraburgosurit dhe të të dënuarit, e cila është pjesë e dosjes mjekësore të tij.”* Në këtë rast kontrolli mjekësor nuk është ushtruar në kohë dhe nëse i dënuari ka refuzuar të vizitohet nga stafi shëndetësor, ky fakt duhet të ishte pasqyruar në dokumentacion.

Pamjet filmike të kamerës së sigurisë, për aq sa lejojnë të kuptohet, nuk përputhen plotësisht me deklaratimet e të dënuarit. Në kamera duket që, në orën 22:28, të datës 11.10.2018, në sektorin e veçimit futen grupi i sigurisë dhe Specialisti i Trupës K. P. Ata fillimisht hyjnë në dhomën nr.2 ku ndodhej i dënuari me probleme të shëndetit mendor I. A., i cili kishte shkaktuar zhurmë. Në orën 22:32:19, Specialisti i Trupës K. P. shkon drejt sportelit të dhomës nr. 6 ku qëndronte M. Th. i ndjekur nga punonjësit e grupit të sigurisë, të cilët i bëhen gardh me fytyrë nga dera e dhomës. Kjo dhomë ndodhet në mes të koridorit të veçimit dhe e vetmja kamera e sektorit nuk arrin të kapë qartë veprimet që kryhen në këtë largësi. Gjatë sektorit janë ndërtuar 10 dhoma. Lëvizjet që kryhen në fund të koridorit duken si vegime të mbuluara në gjysëm errësirë. Në pamjet filmike nuk dallohet që ndonjë polic të ketë goditur me shkop gome në drejtim të derës dhe as që i dënuari M. Th. të ketë nxjerrë duart jashtë sportelit të derës, siç edhe pretendohet prej tij, por vetëm përpjekja e punonjësve të policisë për t'i marrë të dënuarit shkopin e fshesës që kishte dalë nga dritarja e derës. Në orën 22:36, punonjësit e policisë largohen nga dhoma nr. 6 dhe dalin nga sektori me shkopin e fshesës në duar. Në orën 22:46, duket që M. Th. nxjerr dorën te dritarja e dhomës dhe kap me forcë nga uniforma përgjegjësën e sektorit M. H. që i vetëm kishte shkuar për të komunikuar me të. Këtë punonjës M.Th. e përmend në deklaratimet e tij duke thënë se ishte ai që nuk lejoi të hapej dera e dhomës nga grupi i sigurisë që kërkonte ta dhunonte fizikisht.

Nga njohja me pamjet filmike të kamerave të sigurisë u konstatua se, në koridorin e seksionit të veçimit të I EVP Korçë është vendosur vetëm një kamera, e cila nuk të krijon mundësinë për të kuptuar qartë veprimet që bëhen nga mesi i koridorit dhe në fund të tij. Dhoma nr.6, para së cilës pretendohet se kanë vepruar punonjësit e policisë për të goditur të dënuarin M. Th. ndodhet në mesin e koridorit të seksionit të veçimit. Koridori ka gjithsej 10 dhoma. Gjithashtu nga kqyrja e pamjeve u vu re se, në disa fragmente ka kapërcime me disa sekonda deri në një minutë dhe nuk mund të shikohet çfarë ka ndodhur në këtë hark kohor.

Mbikqyrja me kamera e të gjitha mjediseve në I EVP, përveç atyre mjediseve ku çenohet privatësia, është vlerësuar nga ana jonë si një proces thelbësor për tre arsye:

Së pari, mbikqyrja me kamera ka një efekt parandalues për veprime të kundërligjshme që mund të kryhen, si nga ana e të dënuarve, ashtu dhe nga vetë punonjësit e policisë së burgjeve.

Së dyti, mbikqyrja me kamera dokumenton shumicën e ngjarjeve brenda ambjenteve të burgimit dhe paraburgimit, si dhe jep garanci për një gjykim objektiv dhe të paanshëm për masat disiplinore apo penale që eventualisht duhet të merren ndaj individëve përgjegjës.

Së treti, dokumentimi filmik është një material mbi të cilin mund të konsultohen mjaft të dhëna apo pretendime për trajtimin e të dënuarve dhe mund të nxirren përfundime të vlefshme dhe të paanshme në rekomandimet apo raportet përkatëse që harton vetë Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve si dhe institucionet monitoruese të pavarura.

Ndihmëskomisioneri që ka hetuar në dt. 16.10.2018 pretendimin për ushtrim dhune të të dënuarit M. Th. ka konstatuar gjithashtu se, organika nuk ishte e plotësuar me mjek me kohë të plotë dhe mungonte regjistri i dokumentimit të rasteve të ushtrimit të dhunës. Këto konstatime janë bërë edhe nga ndihmëskomisionerë të Mekanizimit Kombëtar për Parandalimin e Torturës, Trajtimin ose Dënimit të Egër, Çnjerëzor ose Poshtëruës , gjatë inspektimit që ata kanë kryer në dt. 29.10.2018 në I EVP Korçë. Lidhur me gjetjet e inspektimit, me shkresën Nr.K4/I11-2, dt. 26.02.2019, i janë dërguar rekomandime I EVP Korçë dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve. I EVP Korçë, me shkresën Nr.534 Prot., dt. 21.03.2019, ka kthyer përgjigje se sektori shëndetësor është pajisur me regjister të evidentimit të rasteve të dhunës dhe se organika është plotësuar me dy mjekë, por me kohë të pjesshme, sepse nuk është ofruar asnjë mjek me kohë të plotë.

Në datën 17.09.2019, Komiteti European për Parandalimin e Torturës, Trajtimin ose Dënimit Çnjerëzor ose Poshtëruës(CPT) ka bërë publik raportin mbi vizitat që ka kryer në disa institucione të privimit të lirisë në Shqipëri, nga data 20 deri në datën 30 Nëntor 2018¹. Në pjesën e raportit që ka të bëjë me I EVP-të, shkronja C, pika 4, përshkruhen konstatimet dhe rekomandimet për stafin shëndetësor në lidhje me dokumentimin e dëmtimeve trupore dhe raportimin e rasteve të dhunës, që sipas CPT-së nuk janë të hollësishme dhe pa përfundime. Në mënyrë të përmbledhur po rendisim rekomandimet e CPT:

Së pari, procesverbali i përpiluar pas ekzaminimit mjekësor të një të burgosuri duhet të përmbajë: (i) një përmbledhje të plotë të gjetjeve mjekësore objektive të bazuara në këqyrjen fizike (shënimin e dëmtimeve traumatike dhe mundësisht fotografitë e dëmtimeve), (ii) marrja e deklarimeve të të burgosurit që janë të rëndësishme për ekzaminimin mjekësor (iii) mendimin e mjekut në varësi të gjetjeve mjekësore objektive dhe deklarimeve. Procesverbali gjithashtu duhet të përmbajë rezultatet e ekzaminimeve shtesë të kryera, përfundimeve të hollësishme të mjekut specialist dhe një përshkrim të trajtimit të dhënë për dëmtimet. Rezultatet e secilit prej ekzaminimeve dhe rezultatet e mjekut duhet ti vihen në dispozicion të dënuarit/të paraburgosurit dhe mbrojtësit të tij ligjor.

Së dyti, sa herë që dëmtimet regjistrohen nga një punonjës i stafit shëndetësor sipas pretendimeve të të dënuarit/të paraburgosurit për keqtrajtim (ose që, edhe në mungesë të pretendimeve, janë tregues i keqtrajtit), rasti i raportohet prokurorisë, pavarësisht dëshirës së personit në fjalë. Stafi shëndetësor duhet ta vërë në dijeni të dënuarin/të paraburgosurin për detyrimin ligjor të mjekut për raportim dhe se ky raportim nuk zëvendëson paraqitjen e një ankese prej vetë të dënuarit/të paraburgosurit;

Së treti, personeli mjekësor që punon pranë institucionit të ekzekutimit të vendimeve penale, duhet të ketë në vëmendje detyrimin ligjor që të raportojë, brenda 48

¹ <https://www.coe.int/en/web/cpt/-/council-of-europe-anti-torture-committee-publishes-report-on-alban-3>

orëve, te prokurori kompetent çdo lëndim/dëmtim që është një tregues i përdorimit të dhunës.

Për sa më lart, bazuar në nenin 63, pika 3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ku thuhet se: “Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut” si dhe në mbështetje të nenit 21/b të ligjit nr.8454 dt.04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit” i ndryshuar ku përcaktohet se: “Avokati i Popullit paraqet rekomandime për marrje masash për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ që, sipas tij, ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive.”

REKOMANDOJMË:

- Vendosijen e të paktën një kamere tjetër të sigurisë në seksionin e veçimit në IEVP Korçë për të monitoruar në përputhje me standartet veprimtarinë në koridorin e këtij seksioni si dhe përmirësimin e regjistrimit të pamjeve në mënyrë që të mos ketë ndërprerje të tyre.
- Sigurimin e shërbimit shëndetësor të të burgosurve pa ndërprerje nën kujdesin dhe kontrollin e personelit mjekësor dhe shëndetësor.
- Zbatimin korrekt të procedurave lidhur me konstatimin e raportimin e dhunës.
- Informimin e punonjësve mbi gjetjet e raportimit të CPT për thellimin e hetimit të rasteve të dhunës.

Për qëndrimin që do të mbani dhe masat që do merrni në zbatim të këtij rekomandimi, na vini në dijeni brenda afatit ligjor 30 ditor, të parashikuar në nenin 22 të ligjit nr. 8454 datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,

KOMISIONERI

Ermonela Ruspi